Republika e Kosovës - Republika Kosova - Republic of Kosovo
Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural
Ministarstvo Poljoprivrede, Šumarstva i Ruralnog Razvoja
Ministry of Agriculture, Forestry and Rural Developement

ANALIZA E TREGUT TË MANAFERRËS

Nëntor, 2019

DEPARTAMENTI I ANALIZAVE EKONOMIKE
DHE STATISTIKAVE BUJQËSORE
(DAESB)

ANALIZA E TREGUT TË MANAFERRËS

Nëntor, 2019

Tabela e përmbajtjes

Parathënie **3**

1 Tregu i manaferrës **4**

2 Prodhimtaria Vendore **5**

3 Zhvillimi i tregtisë **5**

3.1 Importi i manaferrës 5

3.1.1 Importi i manaferrës sipas vendeve 6

3.2 Eksporti i manaferrës 7

3.2.1 Eksporti i manaferrës sipas vendeve 7

3.3 Bilanci tregtar i manaferrës 8

4 Çmimet e tregut **8**

4.1 Çmimet në tregun vendor 9

5 Mbështetja e prodhimtarisë së manaferrës **9**

5.1 Pagesat direkte për kulturën e manaferrës 9

6 Promovimi dhe sfidat për kultivimin e manaferrës **10**

7 Konkluzione **10**

Parathënie

Analiza e tregut të manaferrës e punuar në mënyrë të detajuar nga Departamenti i Analizave Ekonomike dhe Statistikave Bujqësore (DAESB), ka për qëllim të shërbej si një dokument i cili ka të përmbledhura të gjitha të dhënat statistikore të cilat pasqyrojnë gjendjen e tanishme si dhe zhvillimin e tregut të manaferrës në vendin tonë në vite.

Në këtë analizë shtjellohen më gjerësisht të dhënat mbi prodhimtarinë vendore, pasqyra e eksportit dhe importit të manaferrës, çmimet e manaferrës vendore, madhësia e tregut, zhvillimi i tregtisë, mbështetja nga MBPZHR-ja përmes pagesave direkte si dhe në fund konkluzionet finale mbi këtë analizë.

1 Tregu i manaferrës

Manaferra shihet si një kulturë mjaft profitabile për të ardhmen kështu interesimi për kultivimin e manaferrës gjatë viteve të fundit është rritur. Në vitin 2018 sipërfaqja e mbjellur ishte rreth 24 ha. Sa i përket prodhimtarisë manaferra ka pasur një luhatje të vazhdueshme gjatë viteve, ku vitin e fundit në krahasim me vitin 2015 prodhimtaria ishte më e ulët për 13%, kjo pasi viti 2015 ishte viti me prodhimtari më të lartë me një sipërfaqe prej 19 ha. Ndërsa rendimenti ishte 10 tonë/ha, në gjithsej 24 ha sipërfaqe e mbjellur në vitin 2018. Prodhimtaria totale e vitit 2018 ishte 36% më e lartë krahasuar me vitin 2017.

Figura 1: Sipërfaqja, prodhimtaria dhe rendimenti për manaferrën, 2014-2018



Burimi: ASK, përpunuar nga DAESB-MBPZHR

Në figurën 2 është paraqitur numri i ekonomive bujqësore si dhe sipërfaqja e mbjellur me manaferra në regjionet e vendit tonë. Nga figura shihet se në regjionin e Ferizajit është mbjellur sipërfaqja më e madhe gjatë vitit 2014 rreth 30%, pasuar nga Prishtina me 29%, pastaj Prizreni (17%), Gjakova (15%), Gjilani (7%) dhe Mitrovica (2%).

Figura 2: Numri i ekonomive bujqësore dhe sipërfaqja e mbjellur me manaferrë sipas regjioneve, 2014



Burimi: ASK, përpunuar nga DAESB-MBPZHR

2 Prodhimtaria Vendore

Prodhimtaria e manaferrës në vendin tonë për vitin 2018 ishte 246 tonë. Përveç manaferrës së kultivuar në Kosovë, ekziston edhe manaferra e egër e cila grumbullohet dhe kjo prodhimtari kryesisht eksportohet në vendet e tjera dhe përbën pjesën më të madhe të sasisë së eksportuar. Në vitin 2018 sasia e eksportuar ishte rreth 1,815 tonë, ndërsa po në të njëjtin vit sasia e importuar e manaferrës ishte rreth 20.2 tonë gjë që paraqet se vendi ynë ka potencial të lartë me kushte të favorshme klimatike dhe natyrore për kultivimin e manaferrës.

3 Zhvillimi i tregtisë

Manaferra është një ndër kulturat bujqësore për të cilën mund të themi se vendi ynë qëndron mjaftë mirë sa i përket kultivimit, dhe gjithnjë e më tepër po vazhdon të rritet sipërfaqja e mbjellur me të. Në aspektin e tregtisë sasia më e madhe e prodhimit të manaferrës është shitur në treg ndërsa pjesa e mbetur përdoret për nevoja shtëpiake. Gjatë vitit 2018 eksporti i manaferrës kryesisht ka qenë i drejtuar në vendet si: Serbi, Gjermani, Maqedoni. Ndërsa është importuar një sasi e vogël e manaferrës nga Serbia dhe Shqipëria.

3.1 Importi i manaferrës

Gjatë vitit 2018 vendi ynë ka importuar 20.2 tonë manaferrë. Sasia më e madhe e importuar ishte ajo në vitin 2017, në sasi prej 22.9 tonë. Viti 2018 në krahasim me vitin 2017 kishte rënie të importit për 12%

Figura 3: Importi i manaferrës në tonë, 2014-2018



Burimi: ASK, përpunuar nga DAESB-MBPZHR

3.1.1 Importi i manaferrës sipas vendeve

Gjatë periudhës '17-'18 manaferra është importuar nga Maqedonia, Serbia, Shqipëria e të tjera. Sasia më e madhe e importuar gjatë vitit 2017 ishte nga Maqedonia me pjasëmarrje prej 93.4%, pastaj një sasi shumë të vogël të manaferrës vendi ynë e importoi nga Serbia, Shqipëria dhe nga vende të tjera. Sa i përket vitit 2018 sasia më e madhe e manaferrës së importuar ishte nga Serbia me 86.9%, kurse sasi më e vogël u importua nga Shqipëria me 9.9%, ndërsa nga vendet tjera 3.2%.

Figura 4: Importi i manaferrës sipas vendeve, 2017 (majtas) dhe 2018 (djathtas)



Burimi: ASK, përpunuar nga DAESB-MBPZHR

3.2 Eksporti i manaferrës

Sasia e eksportuar gjatë vitit 2018 ishte 1,815 tonë ku në krahasim me vitin 2017 kjo vlerë e eksportit u ngrit për 20%. Vendi ynë gjatë viteve ka eksportuar manaferrë dhe manaferrë të egër, gjë që dëshmon se manaferra ka potencial të lartë në sigurimin e tregut. Në figurë në vijim është paraqitur eksporti i manaferrës në tonë, për periudhën 2014-2018.

Figura 5: Eksporti i manaferrës në tonë, 2014-2018



Burimi: ASK, përpunuar nga DAESB-MBPZHR

3.2.1 Eksporti i manaferrës sipas vendeve

Eksporti i manaferrës sipas vendeve gjatë vitit 2017, është realizuar me një përqindje më të madhe në Serbi me 57%, në Gjermani 23% dhe Itali 7%. Kosova kishte eksportuar edhe në vendet e tjera po me një përqindje më të vogël. Në vitin 2018, Kosova ka eksportuar në Gjermani me 44%, Serbi 43%, në Maqedoni 4%, ndërsa me pjesëmarrje më të vogël është eksportuar në vende tjera.

Figura 6: Eksporti i manaferrës sipas vendeve, 2017 (majtas) dhe 2018 (djathtas)



Burimi: ASK, përpunuar nga DAESB-MBPZHR

3.3 Bilanci tregtar i manaferrës

Bilanci tregtar i manaferrës gjatë periudhës '16-'18 nuk ka pasur luhatje të mëdha. Viti 2018 në krahasim me vitin 2017 ka ngritje të bilancit tregtar për 1.3%. Në figurën e mëposhtme paraqitet ndryshimi në mes eksportit dhe importit ku shprehet se gjatë periudhës '14-'18 ishte gjithnjë bilanci tregtar pozitiv.

Figura 7: Vlera e bilancit tregtar për manaferrën, në 1,000 €



Burimi: ASK, përpunuar nga DAESB-MBPZHR

4 Çmimet e tregut

Manaferra në vendin tonë karakterizohet si një kulturë me kërkesa të vazhdueshme dhe mjaft profitabile ku plasimi në treg nuk shihet si ndonjë problem. Sasia më e madhe nga prodhimtaria e manaferrës në vendin tonë përdoret për konsum familjar, ndërsa pjesa tjetër shitet në tregun vendor po ashtu edhe në tregun jashtë vendit.

4.1 Çmimet në tregun vendor

Manaferrat vendore janë të pranishme në treg gjatë muajit Korrik, Gusht dhe Shtator. Çmimet e manaferrës në tregun vendor dallojnë varësisht nga regjionet, por diferenca e çmimeve nuk është e madhe dhe mesatarja me pakicë është 3.70 €/kg, ndërsa mesatarja me shumicë është 1.20 €/kg. Çmimi minimal me pakicë ishte 3.50 €/kg, ndërsa çmimi maksimal me shumicë ishte 1.50 €/kg. Mund të vërehet se përgjatë viteve ka pasur një luhatje të vogël në çmime.

Figura 8: Çmimet e shitjes së manaferrës vendore, €/kg



Burimi: DAESB - MBPZHR

5 Mbështetja e prodhimtarisë së manaferrës

Programi i pagesave direkte është ndër shtyllat kryesore të mbështetjes që jep shteti për fermerët e vendit tonë. Ndër vite ky program është zgjeruar dhe buxheti në vazhdimësi për përkrahje është rritur. Objektivat që tentohen të arrihen përmes pagesave direkte për kulturën e manaferrës janë: rritja e të hyrave në fermë, përmirësimi i konkurrencës dhe efektivitetit të prodhimit primar bujqësor, mirëmbajtja e vazhdueshme e pemishteve ekzistuese, zvogëlimi i kostos së prodhimit, përmirësimi i cilësisë së prodhimit, rritja e rendimentit dhe intensifikimi i ekonomizimit të aktiviteteve bujqësore.

5.1 Pagesat direkte për kulturën e manaferrës

Kultivuesit e manaferrës për të përfituar nga programi i pagesave direkte duhet të kenë të mbjellura së paku 0.20 ha pemë të imëta (manaferrë) në fushë të hapur ose në serrë. Në rast se fermeri merr tokë me qira gjithashtu edhe sipërfaqja e marrë me qira

duhet të jetë së paku 0.10 ha e pandarë, e dokumentuar përmes kontratës si dhe e kontraktuar në periudhë prej së paku një vit. Subvencionimi në formë të pagesave direkte bëhet për sipërfaqe të mbjellura me manaferrë në vlerë prej 400 €/ha. Kulturat pemëtare që do të mbështeten përmes programit të pagesave direkte, numri minimal i bimëve-pemëve në 1 ha tek manaferra duhet të jetë 1,700 copë.

6 Promovimi dhe sfidat për kultivimin e manaferrës

Viteve të fundit në Kosovë ka filluar të mbahet panairi për promovimin e manaferrës në muajin Gusht i cili zgjat 10 ditë, panair ky i cili gjithnjë e më shumë po tërheq vëmendjen e opinionit për rëndësinë e prodhimtarisë së kësaj kulture në të ardhmen. Panairi mbahet në muajin Gusht të çdo viti në komunën e Prishtinës, përkatësisht në sheshin "Nëna Terezë".

Në vitin 2010 ka filluar fushata për promovimin e prodhimeve bujqësore të vendit "Për sofrën tonë", synimi kryesor i kësaj fushate është ngritja e vetëdijes në masë për rëndësinë ekonomike të konsumit të prodhimeve vendore dhe pjesë e kësaj fushate është edhe manaferra.

Kultivimi i manaferrës është bërë prioritet nga fermerët viteve të fundit, ngase më këtë kulturë ndihmohet në hapjen e vendeve të reja të punës dhe po ashtu në rritje të zhvillimit ekonomik të vendit. Nga të gjitha të arriturat për kultivimin e kësaj kulture në vendin tonë ekzistojnë edhe disa probleme të cilat vazhdojnë të mbesin sfida për kultivuesit e manaferrës, siç janë:

- Kushtet klimatike: Moti i ftohtë (ngrica), në mungesë të shtresës së borës.
- Mungesa e fondeve të veçanta për sigurimin e kulturave bujqësore, për t'i evituar problemet të cilat shkaktohen nga kushtet klimatike.

7 Konkluzione

Nga të gjitha të dhënat dhe statistikat e paraqitura në analizën e tregut të manaferrës mund të konkludojmë se në Kosovë në përgjithësi sipërfaqja e mbjellur me manaferrë është rritur në vitet e fundit, dhe si rezultat i kësaj për t'i mbuluar nevojat e veta vendi ynë importon një sasi shumë të vogël. Gjithashtu bilanci tregtar ka shënuar rritje. Krijimi i kushteve të avancuara për kultivimin e kulturës së manaferrës dhe rritja e sipërfaqes së mbjellur me manaferrë shihet si prioritet për vitet e ardhshme.